



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1699, datë 20.10.2011

Për

“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1653, datë 18.07.2011 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a dhe Albtelecom sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 20.10.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1653, datë 18.07.2011 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a dhe Albtelcom sh.a, të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (**Raporti**);
- Projekt Vendim i KD (**Projekt Akti**);
- Dokumentet shkresore të palëve (**Provat, Pretendimet**);

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918,

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Vendimi nr. 1653, datë 18.07.2011 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a dhe Albtelecom sh.a.”;
2. Shkresa e AKEP nr. 1210 prot, datë 19.07.2011 “*Njoftim Vendimi nr. 1653, datë 18.07.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP*”;
3. Shkresa e Albtelecom sh.a nr. 3015 prot, datë 30.06.2011 “*Marrëveshjes Interkoneksionit ndërmjet operatorit të komunikimeve publike sipërmarrësit Albtelecom sh.a dhe operatorit të komunikimeve publike sipërmarrësit Abissnet sh.a*”;
4. Shkresa e AKEP nr. 1208 prot, datë 19.07.2011 , *Mbi kërkesën ankimore tuajën nr. 1031 prot i AKEP, datë 28.06.2011*, drejtuar Abissnet sh.a dhe Albtelecom sh.a;
5. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R Ë N:

1. AKEP me anë të Vendimit nr. 1653, date 18.07.2011 të Këshillit Drejtues “*Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a dhe Albtelecom sh.a.*”, në pikat 1, 3 dhe 4 të tij ka vendosur:
“Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a dhe Albtelecom sh.a.;
Të njoftohen palët e interesuara Abissnet sh.p.k dhe Albtelecom sh.a për fillimin e procedimit administrativ;
Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit”;

2. Albtelecom sh.a me shkresën nr. 3015 prot, datë 30.06.2011, ka depozituar pranë AKEP kopje të Marrëveshjes së Interkoneksionit të lidhur me sipërmarrësin Abissnet sh.a dhe të nëshkruar midis tyre;
3. Sipërmarrësi Abissnet sh.a i cili ka inicuar fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit me Albtelecom sh.a, edhe pas lidhjes së marrëveshjes së interkoneksionit me Albtelecom sh.a, nuk ka depozituar pranë AKEP kërkesën për tërheqje nga procedimi administrativ,
4. AKEP, me anë të shkresës nr. 1208, datë 19.07.2011 fton sipërmarrësit Albtelecom sh.a dhe Abissnet sh.a në një seancë paraprake dëgjimore në selinë e AKEP me datë 20.07.2011 ora 10:00, në të cilën morën pjesë: përfaqësues e Abissnet sh.a dhe përfaqësues nga AKEP, ndërkohë Albtelecom nuk është paraqitur në këtë seancë dëgjimore. AKEP gjatë seances dëgjimore konstatotoi se:

Abissnet sh.a thekson se çështjet problematike për kompaninë e tyre janë:

- I. Pagesat mujore për qarkun E1 duke vlerësuar se ky detyrim është i papranueshëm pasi gjithë investimi për realizimin dhe instalimi e këtij qarku është bërë nga Abissnet sh.a;
- II. Kamat vonesat e Albtelecom sh.a i konsideron tepër të larta;
- III. Tarifat e tranzitimit të trafikut dalës ndërkombëtar nga Albtelecom;

Abissnet gjatë kësaj seance u shpreh se do të depozitoj me shkrim argumenta në lidhje me zgjidhjen që është propozuar dhe miratuar në ORI-t të operatorëve celularë.

AKEP, pasi diskutoi mbi të gjitha pikat që ishin problematike për operatorin Abissnet sh.a, i kërkoi Abissnet sh.a të depozitojë komentet me shkrim në lidhje me problematikën e lartpërmëndur.

5. Sipërmarrësit Abissnet sh.a dhe Albtelecom sh.a nuk kanë depozituar pretendimet e tyre me shkrim në kuadër të procedimit administrativ brënda afatit të përcaktuar në pikën 4 të Vendimit nr. 1653, datë 18.07.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP;
6. Këshilli Drejtues i AKEP në kushte kur palët në këtë procedim administrativ nuk kanë depozituar pretendimet me shkrim në tejkallim të afatit për depozitimin e tyre të përcaktuar në pikën 4 të Vendimit nr. 1651, datë 18.07.2011, si dhe në mungesë të një kërkesë nga Abissnet sh.a për t'u tërhequr nga procedimi administrativ edhe pas lidhjes së Marrëveshjes së Interkoneksionit me Albtelecom sh.a, çmon të vijojë me shqyrtimin e mosmarrëveshjes për zgjidhjen e saj duke arsyetuar dhe vlerësuar si më poshtë për pikat e marrëveshjes që Abissnet nuk ka qënë dakort apo ka pasur pretendime:

I.Për pretendimin e Abissnet në lidhje me tarifën mujore për cdo lidhje prej 2 Mbps (ose pagesa për qarkun E1) të propozuar nga Albtelecom, ky pretendim (ankesë) nuk qëndron më pasi Albtelecom ka tërhequr këtë propozim dhe nuk aplikon më tarifë për interkoneksionin e bashkevendosur në anën e Albtelecom. Heqja e kësaj tarife është konfirmuar nga Albtelecom me shkresën e Albtelecom nr.3500 prot., datë 29.07.2011 (Nr.1339 prot., datë 1.08.2011: protokollin e AKEP).

II.Për pretendimin e Abissnet në lidhje me aplikimin e kamatvoneses nga Altelecom sh.a prej 0,5 % per cdo dite kalendarike qe tejkalohe afati per pagesat sipas pikes 4, te nenit 17, te MI-se, KD vlereson se ky përcaktim ka qënë edhe më parë në marrëveshjet e interkoneksionit midis operatorëve në Shqipëri dhe është i njëjtë edhe me kamat vonesën e përcaktuar në ofertat referencë të operatorëve celularë me të cilët Abissnet ka nënshkruar marrëveshje interkoneksioni.

III. Për pretendimin e Abissnet për tarifatat e tranzitimit të thirrjeve ndërkombëtare nga Altelecom, AKEP me VKD nr.1468 datë 26.07.2010 ka hequr nga rregullimi tarifatat e tranzitimit ndërkombëtar të Altelecom, duke filluar nga data 1.09.2010, pasi ky treg nuk është më treg i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante dhe Altelecom nuk ka më status me FNT ë këtë treg.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 te nenit 21 te Rregullores së Brëndshme,

V E N D O S:

1. Të mbyllë procedimim administrativ të filluar me VKD nr. 1653, datë 18.07.2011 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a dhe Altelecom sh.a;
2. Të njoftohen palët e interesuara Abissnet sh.a dhe Altelecom sh.a për mbylljen e procedimit administrativ;
3. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**